



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. _____

email: _____

E nderuar

Në vijim të shkresës Tuaj, të administruar në Bashkinë Shkodër me datë 08.01.2020 Ju informojmë si vijon:

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e Bashkisë Shkodër është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve shoqërore për shtresat në nevojë. Bashkia e Shkodrës ka nisur një iniciativë koordinimi me organizatat për të implementuar iniciativa të përbashkëta të shtrira në të gjithë territorin e saj. Procesi është akoma në vazhdimësi e sipër dhe synon hartimin e planeve të përbashkëta dhe ndarjen e përgjegjësisë në përputhje me objektivat strategjike dhe synimet kryesore.

Bashkia Shkodër ka arritur në marrëveshje bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore, me qëllim ofrimin e shërbimeve në territorin e saj, përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit. Ndër shërbimet që ofrohen në bashkëpunim me organizatat janë; fuqizimi socio-ekonomik i familjeve në vështirësi ekonomike, shërbimet alternative të kujdestarisë familjare, mbështetja dhe integrimi i personave me aftësi ndryshe, deinstitutionalizimi, ri-integrimi i fëmijëve migrantë apo të rikthyer nga emigracioni, përfshirja sociale për romët dhe egjiptianët, si një shtysë e mirë për integrimin e këtij komuniteti, mbrojtja dhe trajtimi i viktimave të dhunës në familje, buxhetimi me pjesëmarrje dhe përfshirja e qasjes gjinore në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës, promovimi i territorit të Bashkisë Shkodër, promovimin e produktit territorial. etj.

Për bashkëpunimin me shoqërinë civile, dhe koordinimin e këtij bashkëpunimi, Bashkia Shkodër ka ngritur dhe ka vënë në funksion tryezën konsultative me shoqërinë civile. Kjo tryezë zhvillon një sërë takimesh brenda një viti, dhe synimi i kësaj tryeze është konsolidimi i bashkëpunimit, vlerësimi i nevojave të komunitetit, ofrimi i shërbimeve në përputhje me nevojat e territorit dhe ndarja e shërbimeve sipas nevojave.

Format e bashkëpunimit me shoqërinë civile janë të ndryshme dhe për rrjedhojë procedurat e ndjekura për dhënie të granteve nga Bashkia Shkodër ndaj organizatave të shoqërisë civile janë disa, përmendim këtu marrëveshjet e bashkëpunimit dy palëshe, transfertën, prokurimin me vlerë të vogël, procedurat e ndjekura me Këshill Artistik, Thirrje të hapura në kuadër të Programit Reload, përjashtimin nga detyrimet tarifore.

Thirrje të hapura për OSHC-të në kuadër të Programit Reload

- a) Me qëllim realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, Bashkia Shkodër është shpallur fituese në thirrjen e lançuar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i projektit është që të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet fuqizimit të shoqërisë civile duke mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive në vendimmarrje si dhe nxitjen dhe krijimin e një mjedisi ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.

Bashkia Shkodër ka përmbushur me sukses detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga angazhimi i saj në Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër mori përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projektit ReLOaD dhe angazhimin e organizimit të tre thirrjeve publike (periudhën kohore 2018 – 2020), nga të cilat, dy të parat u financuan nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i Bashkisë) dhe thirrja e fundit u financua nga fondet e vetë Bashkisë. Të gjitha thirrjet për projekt propozime u realizuan në zbatim të VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”.

Në vitin 2018 u realizua thirrja e parë për projekt propozime. Në këtë thirrje aplikuan 20 OSHC nga të cilat 3 u shpallën fitues. Vlera totale e buxhetit për 3 projektet fituese është 7,926,500 lekë.

Në vitin 2019 u realizua thirrje e dytë për projekt propozime. Në këtë thirrje aplikuan 12 OSHC nga të cilat 3 u shpallen fitues. Vlera totale e buxhetit për 3 projektet fituese është 5,487,200 lekë,

Në vitin 2020 u realizua thirrja e tretë publike për projekt propozime. Në këtë thirrje aplikuan 9 OSHC nga të cilat 5 shoqata u shpallen fituese. Totali i grantit në Bashkinë e Shkodrës për këtë Thirrje ishte 10.840.000 ALL. Ndërsa vlera e projekteve të fituara për organizatat e shoqërisë civile ishte 6,630,500 lekë.

Po ashtu në kuadër të Thirrjes së hapur për OSHC/Programi Reload ANTI COVID-19 organizuar nga Reload dhe Bashkia Shkodër është shpallur fitues projekti “Aksion Anti Covid-19” zbatuar nga THE DOOR në vlerën 909,980 All.

Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit.

a) BID Shkodra

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro –Amerikan) ka zbatuar projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “28 Nëntori” dhe “13 Dhjetori”. Zgjerimi ka konsistuar në shtrirjen e aktivitetit të saj edhe të zonës së rrugës këmbësore “Kolë Idromeno”. Tashmë zona e përmirësimit të biznesit (BID) përbëhet nga rr. 13 Dhjetori – rr. 28 Nëntori – rr. Kolë Idromeno. Nga ky bashkëpunim përfitojnë rreth 120 biznese.

b) Shoqata e Artizaneve

Bashkia Shkodër ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit vendor në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artizanatit dhe produkteve territoriale. Në këtë kuadër është lidhur marrëveshja me Shoqatën e Artizanëve e cila ka për qëllim:

- Mbështetjen në organizimin e panairëve, ekspozitave dhe aktiviteteve promovuese sipas kalendarit të miratuar për vitin 2020 të Shoqatës së Artizanëve të Punimeve Artistike të Shqipërisë.
- Përfundimin nga tarifat e përkohshme të Shoqatës së Artizanëve të Punimeve Artistike të Shqipërisë për aktivitetet e organizuara apo në partneritet me Bashkinë Shkodër për promovimin e produktit territorial.

c) Këshilli Artistik Kulturor

Me vendim të Këshillit Bashkiak është ngritur Këshilli Artistik Kulturor, i përbërë nga 7 anëtarë. Përfaqësues të këtij Këshilli janë figura të shquara të artit, kulturës, sportit dhe organizatave të shoqërisë civile. Objekt i veprimtarisë së këtij Këshilli është:

- ✓ Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që nxisin politikat parësore të jetës kulturore, artistike, sportive dhe rinore që kanë impakt dhe zhvillim në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
- ✓ Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që prekin dhe aktivizojnë të gjitha grupmoshat si dhe grupet e interesit në jetën kulturore, artistike, sportive dhe rinore.
- ✓ Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që synojnë dhe afrojnë veprimtari elitare me aktivitete që synojnë pjesmarrje aktive nga një publik i gjërë.

Projektet e parashikuara në buxhetin e Bashkisë në fushat kulturore, artistike, sportive dhe rinore janë të programuara për tu realizuar nga organizatat e shoqërisë civile. Bashkia Shkodër bën shpalljen për realizimin e aktiviteteve artistiko – kulturore. Ftesa është e hapur për të gjithë të interesuarit dhe publikohet në faqen e Bashkisë Shkodër. Pjesë e shpalljes është:

- Përshkrimi i projektit, qellimi i tij;
- Kush ka të drejtën për të aplikuar, kush nuk mund të aplikojë;
- Koha e zhvillimit dhe e shpalljes së fituesit;
- Fondi limit;
- Kriteret e kërkuara;
- Specifika të veçanta (kur ka) për organizimin e aktivitetit;
- Dorëzimi i dokumentacionit;
- Formulari i aplikimit.

Bashkia Shkodër fton të gjithë të interesuarit për të sjellë projektet e tyre pranë Zyrës me Një Ndalesë të saj. Këshilli pas shqyrtimit të projekteve të dorëzuara bën vlerësimin dhe shpalljen e fituesit. I gjithë procesi publikohet në faqen e Bashkisë Shkodër.

d) Në fushën e turizmit

Organizimi i tryezave konsultative me universitetin, bizneset që operojnë në fushën e turizmit dhe organizatat e shoqërisë civile. Qellimi i këtyre takimeve është gjetja e rrugëve të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë, universitetit, bizneseve dhe shoqërisë civile për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Bashkinë Shkodër. Takimet janë periodike, sipas një kalendari të përcaktuar dhe organizohen në formën e diskutimit mes aktoreve pjesëmarrës. Objekt diskutimi është mbarvajtja e sezonit turistik, problematikat e hasura në zhvillimin e sektorit të turizmit e më pas sugjerime se si mund të bëhet më mirë.

e) Në fushën e shërbimeve sociale

Për herë të parë në Bashkinë Shkodër janë ngritur 12 qendrat komunitare "Për familjen" të shtrira në 5 lagjet e qytetit, në disa njësi administrative si dhe shërbimi lëvizës në njësitë administrative të tjera. Qendrat e Bashkisë Shkodër janë hapura dhe po bashkëpunojmë shumë mirë me donatorët dhe OJF, duke realizuar MoU të cilat janë transparente dhe të aprovuara në Këshillin Bashkiak.

Gjithashtu për vitin 2020 Bashkia Shkodër ka realizuar dy transferta specifike për shërbimet sociale si Projekti Shpresa dhe Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa me vlerë 36,164,000 All.

Sa më sipër ju informojmë se për vitin 2020 janë realizuar këto këto bashkëpunime:

Nr.	Përfituesi - OSHC-ja që ka zbatuar aktivitetin/fondin	Shërbimi	Fondet për vitin 2020 Parashikuar	Procedura	Fondet për vitin 2020 Realizuar
1	Programi Reload	Thirrje e hapur për OSHC	10,840,000	Transferime	6,630,500
2	The Door	Thirrje e hapur per OSHC/Programi Reload ANTI COVID-19	909,980	Transferime	909,980
3	BID Shkodra	Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rr. 13 Dhjetori dhe 28 Nentori	1,600,000	Marreveshje bashkëpunimi	832,719
4	Shoqata Teatrore "Zef Jubani"	Karnavalet	500,000	Keshill artistik	500,000
5	Instituti për bashkëpunim dhe zhvillim	Espertizë e jashtme	557,422	Prokurim	552,000
Totali			14,407,402		9,425,199
Transferta specifike për shërbime sociale					
6	Projekti "Shpresa"	Projekti "Shpresa"	19,564,000	Transferime	13,999,601
7	Madonnina della Grappa	Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa	16,600,000	Transferime	13,279,704
Totali			36,164,000		27,279,305
Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqata për përjashtimin nga detyrimet tarifore për përdorimin e hapsirës publike					
8	Shoqata Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë	Zhvillimin e biznesit vendor në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artizanatit dhe produkteve territoriale sipas kalendarit vjetor të miratuar.			

9	Well Point-Kujdes për të gjithë	Në kuadër të projektit "Promovimi i aktiviteteve në Liqenin e Shkodrës dhe Lumin Buna", me qëllim promovimin e aktiviteteve ekoturistike në Liqenin e Shkodrës dhe Lumin Buna.
10	Green Centre Albania	Në kuadër të projektit "Turizëm i qëndrueshëm dhe promovim i produkteve agrourbimorë në zonën e Anës së Malit", me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave ekologjike, kulturore dhe produkteve vendase të njësisë administrative të Bashkisë Shkodër.
11	Mandarina Project	Forcimin e identitetit turistik të Bashkisë Shkodër nëpërmjet promovimit të Markës Zyrtare të Shkodrës.
Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqata		
12	Kongresi Rinor Kombëtar	Në kuadër të projektit "Të veprojmë sëbashku në formësimin e politikave rinore locale dhe qendrore përmes dialogut të strukturuar/PVLR për fuqizimin e rinisë dhe zë për të rinjtë në buxhet".
13	Organizata "Të ndryshëm & Të barabartë"	Sigurimi i funksionimit dhe qëndrueshmërisë së modelit të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve e mbështetjes së fuqizimit të prindërve, duke përdorur kapacitetet dhe mundësitë që jep organizata edhe në përputhje me reformën e decentralizimit, reformën territoriale/administrative dhe atë të shërbimeve shoqërore.
14	Nisma për Ndryshim Shoqëror- Organizata për Gruaja te Gruaja	Përmirësimi i shërbimit ekzistues të emergjencës në qytetin e Shkodrës, ofrimi i shërbimit të emergjencës pas orarit zyrtar të punës, duke përfshirë gjithashtu mbështetje psikosociale në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, transport të sigurtë për rastet si dhe një qendër të strehimit emergjent për gratë, fëmijët dhe të rinjtë në rrezik trafikimi ose viktimeve potencial trafikimi dhe të dhunës në familje.
15	World Vision Albania	Ndërhyrje në përgjigje të emergjencës së krijuar nga COVID-19. Objekti i kësaj marrëveshje konsiston në dhënien e ndihmës për familjarët në nevojë, në zonat e dakortësuara, brenda territorit të Bashkisë Shkodër, me qëllim përballimin e situatës së vështirë të krijuar.
16	Bashkia Shkodër Qendra për të drejtat e gruas Rome/Egjyptiane	Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit romë/egjyptian për tu mbështetur në të drejtat e tyre ligjore dhe sistemin e drejtësisë për zgjidhjen e problematikave me të cilat përballen. Projekti mbështet aktivitete që synojnë mobilizim ligjor në komunitetet romë dhe egjyptiane.
17	Shoqata "The Door"	Ofrimi i shërbimeve integrale dhe edukuese për fëmijët e familjeve vulnerabël dhe në vështirësi socio-ekonomike, pranë ambjentëve të ish-shkollës Veterinare.
18	Shoqata e Para&Tetraplegjikë Shqiptarë	Përmirësimi i mirëqenies së jetës dhe gjendjes sociale, fizike, psikologjike dhe emocionale për personat me aftësi të kufizuara para dhe tetraplegjike.

Baza ligjore

- Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296 dt. 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- VKB nr. 43 datë 19.06.2018 “Për një ndryshim në VKB nr.27 datë 01.06.2016 Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër” është ngritur dhe funksionon Këshilli Artistiko-Kulturor i Bashkisë Shkodër.
- VKB nr. 69, datë 30.10.2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Bashkisë Shkodër dhe Metodologjisë LOD”;
- VKB nr. 1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar, pjesa II, pika 4.10.
- VKM nr. 822 datë, 06/12/2006 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar,në qendrat rezidenciale dhe ditore”.
- Udhezimi nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e Kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”.
- Buxheti vjetor dhe programi buxhetor afatmesëm i Bashkisë Shkodër.

Si dhe një sërë ligjesh të tjera në varësi të fushës së bashkëpunimit.

Së fundi, listën e marrëveshjeve kryesore të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me OSHC-të si dhe të gjitha dokumentat e përmendura mësipër mund ti gjeni të publikuara në faqen e Bashkisë Shkodër, në linkun mëposhtë:

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkia_dhe_shoqeria_civile_1206_1.php

Me respekt,

KRYETAR

Voltana Ademi